REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.3.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË TREGTISË DHE INDUSTRISË PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga Udhëheqësja e ekipit, Arvita Zyferi dhe anëtarëve të ekipit Albesa Tolaj dhe Fanol Hodolli.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 6

2 Qeverisja 9

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli 14

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit 24

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP 25

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak 28


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Ministren dhe stafin e saj për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 25/09/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinioni

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

<u>Opinion i pamodifikuar</u>

Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale. Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

Procesi i menaxhimit të rrezikut nuk po adresohet ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës. Më tutje, MTI ka bërë progres të theksuar në implementimin e rekomandimeve. Prej 22 rekomandimeve, vetëm rekomandimi lidhur me të hyrat nga patentat nuk është implementuar plotësisht.	Ministrja duhet të zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i menaxhimit të rrezikut dhe rekomandimit lidhur me të hyrat adresohen në mënyrë aktive. Kjo të bëhet përmes dokumentimit të aktiviteteve të ministrisë për menaxhimin e këtyre rreziqeve dhe përmes përcjelljes konsistente të rekomandimit lidhur me të hyrat nga patentat (shih çështjet 1 dhe 3).
Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive - ekzistojnë dobësi në disa sisteme të rëndësishme financiare duke përfshirë, subvencionimin, pasurinë dhe personelin.	Ministrja duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave me mangësi të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 5 deri 9).

Përgjigja e Ministres së Tregtisë dhe Industrisë - auditimi 2015

Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuare në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarim material të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministrja është përgjegjëse për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

MTI kërkohet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e Ligjit të buxhetit për 2015;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€;
- Raportet për borxhet e papaguara;
- Plani preliminar dhe final i prokurimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit.

Në kontekst të PVF-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 24/11/2015, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti. Në draft Pasqyrat Financiare nuk ishin të nevojshme të bëhen korrigjime financiare.

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Po ashtu, në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MTI-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzueseve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

- Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Krahasuar me vitin e kaluar, menaxhmenti i MTI-së ka bërë përmirësime të theksuara në aranzhimet e qeverisjes së mirë. Kjo për faktin se, MTI ka arritur t'i implementoj plotësisht 16 rekomandime nga 22 rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit të vitit të kaluar. Megjithatë, edhe më tutje duhet të punohet për implementimin e të gjitha rekomandimeve. Më tutje, auditimi i brendshëm si pjesë e rëndësishme e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike ka mbështetur menaxhmentin në përmbushjen e objektivave të organizatës. Kontrollet efektive në këtë fushë kanë ndihmuar menaxhmentin në vlerësimin e funksionimit të kontrolleve në të gjitha agjencitë dhe marrjen e veprimeve për korrigjim me kohë.

Megjithatë, ekzistojnë ende disa mangësi në qeverisjen e MTI-së, në veçanti mangësitë në lidhje me menaxhimin e rrezikut përfshirë identifikimin e rreziqeve dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Lista kontrolluese e vetvlerësimit, e plotësuar nga MTI, e pasqyron këtë situatë pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese. Aranzhimet e tjera

të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rreziqeve me të cilat organizata mund të ballafaqohet gjatë përpjekjes për realizimin e objektivave, nuk janë të dokumentuara nga MTI.

Edhe pse MTI-i ka bërë një numër përmirësimesh në menaxhimin e burimeve njerëzore, kjo fushë kërkon përmirësime të mëtejshme. Kjo për faktin se, transferet e punëtorëve në pozita të ndryshme nga kabineti i kaluar në MTI, ka rezultuar me numër të lartë të zyrtarëve në procedura ankimore.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të MTI-së ka rezultuar me 22 rekomandime. MTI kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, 16 rekomandime janë implementuar plotësisht; pesë (5) janë adresuar pjesërisht dhe vetëm një (1) nuk është adresuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura	MTI ka bërë progres të theksuar në implementimin e rekomandimeve. Pothuajse të gjitha rekomandimet e dhëna vitin e kaluar janë implementuar. Megjithatë, përkundër progresit pesë (5) rekomandime nuk janë implementuar plotësisht dhe rekomandimi lidhur me menaxhimin e të hyrave në API nuk është adresuar ende.
Rreziku	Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kanë rezultuar në mangësi në fushën e pasurisë, personelit dhe të hyrave të përsëritura vit pas viti.
Rekomandimi 1	Ministrja duhet të sigurojë që ka aplikuar një proces formal të monitorimit të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga AP, me qëllim që të mbaj llogaridhënës stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MTI-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2– Lista kontrolluese e vetvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë (6) pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë (5) komponente. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1.

Rreziku Aranzhimet jo të plota të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 2 Ministrja duhet të sigurojë se aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MTI operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në komponentin e 2-të të pyetësorit të vetvlerësimit kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik. Po ashtu, dispozitat e LMFPP-së si dhe Rregulla Financiare e Thesarit nr. 01-2010 përcaktojnë që ZKA është përgjegjës për zbatimin e aranzhimeve, procedurave dhe sistemeve për të siguruar përmbushjen e objektivave kyçe të organizatës dhe për të identifikuar rreziqet drejt arritjes së këtyre objektivave, si dhe për të ndërmarrë hapa për të menaxhuar ato rreziqe.

Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut –Prioritet i lartë

E gjetura MTI nuk ka krijuar një listë me rreziqe që identifikon pengesat e mundshme krahas përmbushjes së objektivave. Si rrjedhojë, MTI është duke u përballur me vështirësi në menaxhimin e stafit në disa pozita kyçe të cilat janë duke funksionuar me ushtrues detyre për periudha 3 mujore. Një ndër këto është edhe pozita e Sekretarit të Përgjithshëm e që ka një rol kyç në përmbushjen e objektivave të organizatës.

Rreziku Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se, veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

Rekomandimi 3 Ministrja duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.

Më tutje, krahas regjistrit të rreziqeve duhet të përpiloj edhe planin aksional për monitorimin e gjasës së ndodhjes së atyre rreziqeve dhe ndërmarrjen e masave për ti sjell në kufirin e pranueshëm. Kjo do të evitonte pengesat potenciale në arritjen e objektivave të ministrisë.

Çështja 4 - Organizimi i Brendshëm dhe Sistematizimi i Vendeve të Punës në MTI – Prioritet i lartë

E gjetura Në mbështetje të rregullores nr. 29/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MTI, kabineti i kaluar kishte bërë transfere të punëtorëve në pozita të ndryshme të cilat kishin rezultuar me pakënaqësi të shumta tek stafi i saj. Si rezultat i kësaj kemi një numër të lartë të ankesave në vazhdimësi nga viti në vit në MTI. Vetëm për vitin 2015, kanë qenë katër(4) lëndë në komisionin disiplinor, 59 lëndë në Komisionin për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave në MTI dhe 23 lëndë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil .

Rreziku Menaxhimi jo i mirë i numrit të stafit dhe mos sistemimi i tyre në pozita adekuate rrit rrezikun e mos arritjes së objektivave të ministrisë dhe mund të ndikojë negativisht në motivimin e stafit si dhe proceset gjyqësore mund t'i shkaktojnë humbje të tjera financiare.

Rekomandimi 4 Ministrja duhet të sigurojë se do të bëhet një rishikim i proceseve për menaxhimin e personelit dhe sistematizimin e të punësuarve sipas përvojave adekuate për të siguruar respektimin e rregullave në fuqi dhe përfitimin më të mirë nga kapacitet ekzistuese njerëzore në kuadër të MTI-së.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) funksionon me përbërje të një auditori të brendshëm dhe drejtorit të NjAB-së. Njësia ka një plan vjetor të punës të derivuar nga strategjia e auditimit të brendshëm të periudhës 2015-2017. Plani i auditimeve për vitin 2015 ka të parashikuar pesë auditime të rregullta dhe tri me kërkesë të menaxhmentit dhe të gjitha ishin realizuar sipas planit. Qasja e auditimit të brendshëm ishte e bazuar në rreziqe dhe në ngjarjet aktuale të MTI-së. Komiteti i auditimit kishte mbajtur takime të rregullta dhe kishte shqyrtuar të gjitha rekomandimet e NJAB.

Menaxhmenti i ka trajtuar me kujdes rekomandimet e AB-ë dhe ka marrë masa për implementimin e tyre. Po ashtu edhe komiteti i ka shqyrtuar të gjitha rekomandimet e AB-së dhe ka dhënë këshilla se si të veprohet më tutje.

Kontrollet efektive në këtë fushë e kanë ndihmuar menaxhmentin e MTI-së në vlerësimin e funksionimit të kontrolleve në të gjitha agjencitë dhe marrjen e veprimeve për korrigjim me kohë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

MTI për vitin 2015, ka ndërmarr masa proaktive në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të Ministrisë.

Procesi buxhetor në 2015, krahasuar me vitin 2014 është përmirësuar dukshëm. Si rezultat, buxheti final për 2015 është realizuar 97%. Edhe pse në këtë përqindje kanë ndikuar edhe vendimet e Qeverisë për reduktimin e fondeve në fund vit. Po ashtu, menaxhimi i të hyrave si dhe menaxhimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime si dhe investime kapitale është përmirësuar dukshëm, edhe pse ende ekzistojnë disa mangësi specifike në këto dy fusha.

Përkundër masave të ndërmarra, veprime shtesë nevojiten në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe menaxhimit të pasurisë. Numri i lartë i rasteve në procedura ankimore, mos harmonizimi i koeficienteve me pozitat përkatëse nuk siguron menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore për të arritur objektivat e synuara. Po ashtu, mos krijimi i një depoje për sistemimin e pasurive të organizatës rrezikon humbjen apo keqpërdorimin e tyre.

Më tutje, MTI bazuar në rekomandimet tona vitin e kaluar ka hartuar udhëzimin administrativ për menaxhimin e subvencioneve. Ne, e mirëpresim angazhimin e MTI-së për sigurimin e parakushteve për menaxhimin më të mirë të subvencioneve. Megjithatë, duhet të siguroj zbatimin e plotë e udhëzimit në të ardhmen me qëllim të arritjes së objektivave të synuara me subvencionim.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MTI, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[1]	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**5,459,627**	**4,893,630**	**4,731,018**	**4,876,578**	**5,346,218**
Granti i Qeverisë -Buxheti	5,459,627	4,891,036	4,730,493	4,876,577	5,331,029
Të bartura nga viti paraprak –					15,188

Buxheti final është më i ultë se buxheti fillestar për 565,996€. Ky zvogëlim është rezultat i rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë në kategoritë në vijim:

- 101,578€ janë zvogëluar pagat dhe mëditjet;
- 346,955€ janë zvogëluar mallrat dhe shërbimet;
- 223,999€ janë zvogëluar investimet kapitale; dhe
- 106,535 janë rritur subvencionet dhe transferet.

Zvogëlimet e buxhetit të cekura më lartë kanë ndodhur pas mbylljes së afatit të pagesave ku Ministria e Financave ka tërhequr të gjitha mjetet e pa shpenzuara nga Linjat Buxhetore të MTI-së.

Në vitin 2015, MTI ka përdorur 97% të buxhet final ose 4,731,018€, me një përmirësim prej 13% krahasuar me vitin 2014. Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**5,459,627**	**4,893,630**	**4,731,018**	**4,876,578**	**5,346,218**
Paga dhe Mëditje	1,414,603	1,313,025	1,313,025	1,309,367	1,107,418
Mallrat dhe Shërbimet	1,935,744	1,588,789	1,432,027	1,649,701	2,944,361
Shërbimet komunale	89,280	89,280	84,516	87,673	93,668
Subvencionet dhe Transferet	1,000,000	1,106,535	1,106,535	973,000	-
Investimet Kapitale	1,020,000	796,001	794,915	856,837	1,200,771

[1] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

MTI kishte shpenzuar buxhetin për paga dhe mëditje 100%, për mallra dhe shërbime 90%, për Investime kapitale dhe subvencione transfere 100%, si dhe për shpenzime komunale 95%.

Tabela 3.Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës nga MTI/ ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetanake	1,887,894	1,887,894	1,887,894	1,707,058	1,990,388
Totali	**1,887,894**	**1,887,894**	**1,887,894**	**1,709,653**	**1,990,388**

Të hyrat e gjeneruara nga MTI në vitin 2015 ishin në total 1,887,894€.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Prokurimi

Shpenzimet e Prokurimit për vitin 2015, ishin rreth 1.2 milion€. Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit të tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Çështja 5 – Mangësi në zbatimin e ndëshkimeve për vonesat në realizimin e kontratës – Prioritet i mesëm

E gjetura Auditimi jonë mbi menaxhimin e shpenzimeve identifikoi çështjen në vijim:

Bazuar në kontratat e lidhura në mes të MTI-së dhe Operatorëve Ekonomik (OE), MTI ka të drejtën e aplikimit të ndëshkimeve nëse ka vonesa në realizimin e kontratës. Në dy (2) kontrata të cilat ishin të vitit 2014, kishte pasur vonesa në kryerjen e punëve deri në shtatë muaj. Në kontratën për " Riparimin e Objektit të MTI-së", MTI nuk kishte aplikuar fare ndëshkimet për vonesa në dy situacionet e fundit në vlerë prej 24,089€. Përderisa, në kontratën tjetër për "Ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe industrial të PBD-së", MTI nuk kishte aplikuar ndëshkimet vetëm për situacionin e katërt në vlerë prej 36,635.88€.

Rreziku Mos kryerja e punimeve me kohë nga ana e OE ndikon në ngecjen e aktiviteteve të ministrisë dhe mos arritjen e objektivave të saj. Më tutje, rritë rrezikun që planet e ardhshme të shpenzimeve të mos arrihen për shkak të nevojës për t'i paguar shpenzimet që dalin si rezultat i vitit paraprak.

Rekomandimi 5 Ministrja duhet të analizoj shkaqet që kanë çuar në vonesën e kryerjes së punimeve, dhe të sigurojë se të gjitha projektet e kontraktuara menaxhohen me kohë, në të kundërtën të aplikoj ndëshkimet.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Avanset, Komunalit

Në kuadër të shpenzimeve tjera ne kemi testuar shpenzimet për udhëtime zyrtare, menaxhimin e avanseve të ndërlidhura me këto shpenzime, si dhe komunalit. Këto shpenzime ishin menaxhuar në përputhje me rregulloret në fuqi.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përkundër masave të ndërmarra në adresimin e mangësive të identifikuara në auditimin e vitit 2014, menaxhimi i burimeve njerëzore vazhdon të jetë sfidues për MTI-në. Si rezultat i kësaj, proceset që kanë të bëjnë me harmonizimin e koeficientave me pozitat përkatëse dhe pagesa e pagave nga departamentet përkatëse nuk ishin bërë në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore.

Çështja 6 - Menaxhimi i burimeve njerëzore – Prioritet i lartë

E gjetura

Gjatë testimit të kësaj kategorie kemi vërejtur mangësitë në vijim:

Mos harmonizim i koeficienteve me pozitat përkatëse. Më poshtë do ti cekim disa raste:

1. në 6 raste asistentët administrativ paguhen me koeficient 5, ndërsa në 3 raste me koeficient 6;

2. në 4 raste Të punësuarit si zyrtarë paguhen me koeficient 6, në 4 raste me 7.5, ndërsa në 41 raste paguhen me koeficient 7;

3. në 4 raste Zyrtarët e lartë paguhen me koeficient 7, në 3 raste me koeficient 7.5, ndërsa në 32 raste me koeficient 8; dhe

4. në 1 rast Udhëheqësi i sektorit paguhet me koeficient 7, në 5 raste me koeficient 9 ndërsa në 3 raste me koeficient 8.

MTI përmes shkresave në Ministrinë e Administratës Publike dhe në MF kishte bërë disa herë përpjekje për harmonizimin e koeficientëve, mirëpo kishte marrë përgjigje negative nga këto institucione për shkak të limitimeve buxhetore.

Mos harmonizim i numrit të stafit të aprovuar sipas Ligjit të **Buxhetit me numrin aktual të stafit në departamente.** Ligji i buxhetit përcakton për çdo vit kalendarik numrin e të punësuarve për secilin departament apo agjenci si dhe shumën e buxhetuar për atë numër të punëtorëve. Katër (4) zyrtarë[2] të departamenteve të ndryshme paguhen nga kodi buxhetor i departamenteve tjera. Sipas MTI-së, kjo ka ndodhur si rezultat i mos përputhjes mes Rregullores së brendshme nr. 29/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës e aprovuar në vitin 2012 me disa ligje në fuqi të kësaj ministrie, pasi që shumica e ligjeve ose janë aprovuar pas hyrjes në fuqi të rregullores ose ende nuk janë aprovuar.

Funksionimi i fondit të kuadrove. MTI nuk i ka kryer të gjitha detyrat e saj të përcaktuara me Rregulloren për Funksionimin e fondit të kuadrove, përkatësisht Neni 4 pika, ku thuhet se stafi politik, sekretarët e përgjithshëm, ushtruesit e detyrave të pozitave të caktuara nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga FK-ja. Në tre (3) raste ministria ka paguar zyrtarët të cilët kanë përfituar nga ky fond edhe për periudhën kur zyrtarët kanë qenë Ushtrues Detyre të pozitave të caktuara. Këto lëshime ishin si rezultat i dhënies së fondit për kuadro në fund të vitit.

[2] Raste të tilla janë hasur tek departamenti i Industrisë, Agjensioni i Metrologjisë, departamenti i Tregtisë, si dhe Divizioni për mbrojtjen e konsumatorit.

Kompensimi i pagës për periudhën e suspendimit. Sipas LSHC (Ligji për Shërbyesit Civil) për periudhën e pezullimit parandalues nga puna, nëpunësit civil i takon kompensimi në lartësi prej 50% të pagës gjatë kohëzgjatjes së pezullimit deri në vendimin përfundimtar nga gjykata. Zyrtari i materialit të ndërtimit dhe shfrytëzimit të resurseve në departamentin e ndërtimtarisë me vendim të datës 10 shtator 2014 është pezulluar nga puna me kompensim 100% të pagës deri në nëntor 2015.

Sipas MTI-së, arsyeja e mos pezullimit të pagës prej 50% për zyrtarin e suspenduar ishte si rezultat i mos pranimit të një raporti nga policia**.**

Rreziku Mos harmonizimi i koeficienteve për pozitat përkatëse, numri i pa harmonizuar i punëtorëve në departamente, kompensimet e shtesave dhe pagës jo në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore mund të ndikojnë në cilësinë e punëve dhe mund të sjellin ministrinë në vështirësi financiare.

Rekomandimi 6 Ministrja duhet të sigurojë se të gjitha pagesat për paga dhe mëditje bëhen në përputhje me përshkrimin e detyrave të punës dhe për përfituesit e fondit të kuadrove të aplikojë rregulloren në fuqi. Po ashtu duhet të siguroj se numri dhe shpërndarja e të punësuarve brenda departamenteve të organizatës është në përputhje me Ligjin e buxhetit.

3.6 Subvencionet dhe Transferet

MTI zbaton një mori kontrollesh me rastin e procesit të subvencionimit. Vëmendje e shtuar i kushtohet monitorimit të tyre, si hap me rëndësi të veçantë i procesit, për shkak të natyrës së ndjeshme të kësaj kategorie. Gjatë vitit 2015, MTI nuk kishte pasur një udhëzim të brendshëm që përcakton procedurat e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve.

Në fazën e dytë të auditimit na është prezantuar udhëzimi administrativ i cili është në fuqi nga fillimi i vitit 2016. Ne e mirëpresim iniciativën e MTI-së për përgatitjen e këtij udhëzimi. Megjithatë, me gjithë zbatimin e një numri të madh të kontrolleve ne kemi vërejtur që kjo fushë është përcjellë edhe me mangësi.

Çështja 7 Mangësi në menaxhimin e subvencioneve –Prioritet i lartë

E gjetura

Ligji mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë neni 37 kërkon që "fondet të jenë të zotuara për përmbushjen e një obligimi respektivisht për përmbushjen e një obligimi kontraktues".

Në një rast kontrata për dhënie të subvencioneve ishte nënshkruar para zotimit të mjeteve. Qëllimi i këtij subvencioni ka qenë organizimi i panairit në shumë prej 7,750€. Marrëveshja është nënshkruar me 15.04.2015 kurse zotimi i mjeteve është bërë me datë 20.04.2015.

MTI përkatësisht KIESA, nuk ka një proces transparent të dhënies së subvencioneve, nuk ka kritere për të përcaktuar se kush ka përparësi në përfitimin e subvencioneve si dhe nuk bënë shpallje publike për shprehje interesi nga ana e OJQ-ve. Kjo mangësi është vërejtur në pesë (5) raste ku nuk kishte kritere të përcaktuara dhe shpallje publike për aplikantët.

Rreziku

Dhënia e subvencioneve pa shpallje publike dhe pa kritere të qarta eliminon konkurrencën, mundëson subvencionimin e përfitueseve të papërshtatshëm si dhe rrit rrezikun e shpenzimit të parasë publike në mënyrë jo racionale. Ndërsa, nënshkrimi i kontratës para zotimit të fondeve rrit rrezikun e hyrjes në obligime pa pasur mjete për pagesën e tyre.

Rekomandimi 7

Ministrja duhet të sigurojë se vendimi për dhënien e subvencioneve merret pasi të zotohen mjetet e mjaftueshme për pagesën e tyre, përfituesit përzgjidhen në bazë të kritereve specifike dhe të qarta dhe duke ndjekur një proces të hapur dhe transparent.

3.7 Të Hyrat

Menaxhimi i të hyrave është në nivel të kënaqshëm, megjithatë duhet të punohet më tepër për të siguruar se respektohen afatet ligjore për aprovimin e kërkesave të konsumatorit.

Çështja 8 - Vonesë në shqyrtimin/ aprovimin e kërkesave nga konsumatorët - Prioritet i lartë

E gjetura

Në Ligjin për Patenta, specifikohet që zyra për patenta duhet të nxjerr vendimin pas afatit prej tetëmbëdhjetë (18) muajve nga data e dorëzimit të aplikacionit. Megjithatë, në këtë ligj nuk është e cekur periudha për shqyrtimin e kërkesave të konsumatorëve. Sipas zyrtarëve të MTI –se arsyeja e vonesave në shqyrtimin e kërkesave ishte pasojë e trashëgimit të një numri të madh të lëndëve/kërkesave nga vitet e kaluara.

API kishte marrë 52 vendime për patenta por ato ishin marrë me vonesa të konsiderueshme. Këtë vit ishin nxjerr vendime për të cilat kërkesat janë para 7 vitesh (1 rast), para 5 vitesh (11 raste), para 4 vitesh (30 raste) si dhe para 3 vitesh (9 raste).

Rreziku

Vonesat në aprovimin e kërkesave për patenta rrisin rrezikun për shërbim jo efikas ndaj subjekteve afariste, si dhe shkaktojnë dëme buxhetore për shkak të mos-grumbullimit të të hyrave me kohë. Më tutje, mos efikasiteti në shqyrtimin e kërkesave të konsumatorëve ka për pasojë ngecjen në zhvillimin e tregut privat dhe ekonomisë në përgjithësi.

Rekomandimi 8

Ministrja duhet të siguroj se janë nxjerrë aktet nënligjore të cilat përcaktojnë qartë afatet kohore për shqyrtimin/aprovimin e kërkesave për patenta. Shqyrtimi i kërkesave nga subjektet afariste brenda afateve të caktuara ligjore do të parandalonte zhvillimin e veprimtarive pa patenta në sektorin privat.

3.8 Pasuritë dhe detyrimet

3.8.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Mbajtja e regjistrit përmbledhës të pasurisë në MTI bëhet me softuerin e-pasuria. Zyrtarja e pasurisë bënë regjistrimin e pasurive mbi 1000€ në SIMFK ndërsa në e-pasuri regjistron vetëm vlerat jokapitale. Menaxhimi i pasurisë është përcjellë me sfida në MTI.

Çështja 9 – Menaxhimi i pasurisë në nivel jo të mirë - Prioritet i lartë

E gjetura

Neni 18 i rregullës financiare për menaxhimin e pasurisë kërkon që OB-të të kryejnë një herë në vit inventarizimin e pasurisë me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. MTI për vitin 2015 kishte formuar komisionin për këtë qëllim mirëpo raporti final i inventarizimit ishte përgatitur në maj 2016.

Po ashtu për shkak të mungesës së një depoje me hapësirë të mjaftueshme, zyrtarët nuk shkarkohen me pasuritë të cilat ata nuk i përdorin më. Ato i mbajnë nëpër zyrat e veta apo në vendet ku ata e konsiderojnë të përshtatshme, ndërkohë që zyra e financave nuk ka evidencë të plotë për pasuritë jashtë përdorimit.

Rreziku

Mungesa e kontrolleve rreth gjendjes së pasurisë së organizatës rrit rrezikun e keqpërdorimit nga zyrtarët e MTI-së.

Rekomandimi 9

Ministrja duhet të sigurojë se janë ndërmarrë hapa konkretë për sigurimin e një depoje dhe për përgatitjen e raportit të inventarizimit me kohë në mënyrë që të ketë kontrolle adekuate rreth pasurisë së MTI-së.

3.8.2 Trajtimi i borxheve

MTI raporton me rregull në MF lidhur me obligimet e papaguara. Obligimet e papaguara kishin të bëjnë kryesisht me faturat e pranuara me gabime nga OE të cilat janë kthyer për korrigjim.

Çështja 10 - Mos protokollimi i faturave të pranuara – prioritet i mesëm

E gjetura	Sipas rregullores së thesarit për shpenzime nr. 01/2013 neni 24, çdo faturë e cila pranohet në OB duhet të protokollohet. Gjatë testimit të obligimeve kemi vërejtur se dy (2) fatura njëra me nr. 81 vlera 1,335€, dhe tjetra me nr.24434 vlera 110€ të cilat ishin paguar, nuk ishin të protokolluara.
Rreziku	Mos protokollimi i faturave me rastin e pranimit në OB rrit rrezikun e vonesës në pagesën e faturave më gjatë se 30 ditë.
Rekomandimi 10	Ministrja duhet të sigurojë se çdo faturë e cila pranohet në MTI kalon përmes protokollit për të shmangur rrezikun e vonesës në kryerjen e obligimeve.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditivit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçë për të cilat Ministrja duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do ti raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implemetuara	Të adresuara por jo të implemetuara	Të pa adresuara
1. Pasqyrat Financiare	Ministrja duhet të inicojë analiza të arsyeve për mos regjistrimin e pasurive kapitale në regjistrin kontabël dhe të identifikojë veprimin e duhur për t‟i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2015.	PO		
2. Pasqyrat financiare	Ministrja duhet të siguroj se procesi i përgatitjes së PVF 2014 edhe formalisht përfshin rishikimin e draft pasqyrave nga menaxhmenti, me fokus të veçantë mbi fushat me rrezik të gabimit dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet paraprake.	PO		
Rekomandimet e vitit paraprak	Ministrja duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	PO		
Qeverisja e mirë	Ministrja duhet të marrë masat e nevojshme që sfidat raportuara nga vetë zyrtarët e MTI-së për aktivitetet e departamenteve ose agjencive përkatëse të merren parasysh nga menaxhmenti dhe të bëhet një plan i detajuar ku janë të përshkruara sfidat e organizatës dhe zgjidhjet e mundshme.	PO		
Qeverisja e mirë	Ministrja duhet të inicojë shqyrtimin e aranzhimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe kërkesave që i bëhen agjencive ekzekutive për raportim, me theks të veçantë në lidhje me menaxhimin e pasurive në mënyrë që të parandalojë keqpërdorimin e pasurive të organizatës.	PO		

Qeverisja e mirë	Ministrja duhet të sigurojë se ka ngritur çështjen e mos bashkëpunimit të komunave me MTI-në tek autoritet përkatëse për të siguruar një koordinim sinjifikant të aktiviteteve të Inspektoratit në mënyre që të shmanget puna e dyfishtë.		Janë marrë masa nga ministria dhe procesi është duke shkuar mirë.	
Qeverisja e mirë	Ministrja duhet të sigurojë se bazuar në numrin e aprovuar të stafit bëhet rekrutimi sipas nevojave të agjensioneve dhe departamenteve në mënyrë që të sigurohet arritja e objektivave të ministrisë. Për më tepër, menaxhmenti duhet të bëjë përpjekje aty ku është e mundur që edhe stafin ekzistues ta akomodojë nëpër departamente ku ka nevojë për staf shtesë.		Janë marrë masa por ende ka raste të tilla.	
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministrja duhet të sigurojë monitorim në mënyrë sistematike performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e realizimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	PO		
Të hyrat	Ministrja duhet të sigurojë një mekanizim adekuat për sigurimin e të hyrave nga API në përputhje me UA nr.08/2013.	PO		
Të hyrat	Ministrja duhet të sigurojë përmes ARBK-së se asnjë likuidim nuk përfundohet pa i plotësuar kërkesat ligjore lidhur me dokumentacionin e kërkuar.	PO		
Të hyrat	Ministrja përmes API-së duhet të sigurojë implementimin e plotë të kërkesave ligjore dhe në përputhje me obligimet e dala nga këto të sigurojë edhe pagesën e tarifave dhe vjeljen e të hyrave ligjore nga API.	PO		
Të hyrat	Ministrja duhet të siguroj se të gjitha kërkesat e subjekteve afariste shqyrtohen dhe merret vendim brenda afatit ligjor për të parandaluar zhvillimin e veprimtarive pa licenca në sektorin privat dhe shërbimin jo efikas ndaj konsumatorëve.	PO		

Të hyrat	Ministrja duhet të sigurojë një mekanizim adekuat për ekzaminimin e lëndëve në afatin e paraparë ligjor dhe njëkohësisht të sigurojë implementimin e plotë të Ligjit për Patenta nr.04 /L-029.			Nuk është adresuar ende.
Shpenzimet me prokurim	Ministrja duhet të sigurojë se rishikimi i procedurave dhe proceseve në fushën e prokurimit është bërë në të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive me qëllim të evitimit të gabimeve dhe lëshimeve sistematike.Plani i prokurimit duhet të përgatitet në bazë të nevojave reale të furnizimit gjatë vitit dhe vlera e përafërt e kontratave duhet të llogaritet për të mundësuar zotimin adekuat te mjeteve. Po ashtu, duhet të shtoj kontrollet në sektorin e pagesave për të siguruar procedimin e tyre në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullat në fuqi.	PO		
Shpenzimet pa prokurim	Ministrja duhet të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se biletat rezervohen vetëm nga klasa e lejuara të udhëtimeve dhe se para shpenzimit të parasë publike bëhet hulumtimi i mjaftueshëm i tregut për t'i arsyetuar pagesat e bëra.	PO		
Personeli	Ministrja duhet të sigurojë që një rishikim bëhet për mënyrën e menaxhimit me burime njerëzore për të siguruar respektimin e rregullave në fuqi dhe përfitimin më të mirë nga kapacitet ekzistuese njerëzore në kuadër të MTI-së. Në këtë aspekt, vendimet e marra lidhur me vendosjen tepricë të nëpunësve, ndryshimin e kritereve për punësim dhe transferin e nëpunësve nga një pozitë në tjetrën, duhet të arsyetohen mirë dhe të mbështetën me argumente të qëndrueshme me qëllim të evitimit të pasojave të padëshiruara nga shfuqizimi i tyre.		Vetëm një pjesë e çështjeve të theksuara në këtë fushë janë trajtuar por ka ende sfida të mëdha në fushën e personelit.	
Subvencionet	Ministrja duhet të sigurojë se gjatë dhënies së subvencioneve evitohen situatat që mund të krijojnë konflikt interesi dhe krijojnë mundësin për favorizime dhe përfitime individuale.	PO		

Pasuria	Ministrja duhet të sigurojë mekanizma adekuat për menaxhimin dhe ruajtjen e pasurisë së organizatës. Në vazhdim një evidencë e saktë për çdo lëvizje të pasurive brenda MTI-së duhet të formohet.		Pjesërisht e implementuar	
Llogaritë e arkëtueshme	Ministrja duhet të siguroj se ekziston një sistem i mirëfilltë i regjistrimit të llogarive të arketueshme me qëllim që evidencat të përmbajnë vetëm ato llogari të arkëtueshme të cilat i plotësojnë kriteret për regjistrim.	PO		
Obligimet	Ministrja duhet të sigurojë se asnjë faturë nuk pranohet pa u bërë fillimisht pranimi i mallit dhe pa u protokolluar fatura. Po ashtu, duhet të sigurojë se janë kryer të gjitha obligimet e vitit paraprak para se të vazhdohet me pagesat e vitit aktual.		Pjesërisht e implementuar	
Auditimi i brendshëm	Ministrja duhet të sigurojë se aktiviteti i ardhshëm i AB-së duhet të orientohet drejt zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në rrezik. Kjo do t‟i jepte menaxhmentit siguri vjetore për sa i përket efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për të gjitha rrjedhat e të hyrave,shpenzimeve domethënëse dhe rezultateve.	PO		
Auditimi i brendshëm	Ministrja duhet të sigurojë se përfitimi nga puna e AB merret në konsideratë duke përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të NJAB-it dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete në implementimin e tyre.	PO		